

Akt themelimi
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“East Hotel Tirana ” SHPK

Kapitulli I

FORMA, EMËRTESA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA DHE SELIA

Sot më datë 20/05/2024, në adresën TIRANE,Rr.LUNDER, Pasuria nr.583/57-N1, Zona Kadastrale 2529:

1. Shoqëria “Praslin Investment” shpk, identifikuar me NUIS K52113007F, me adresë në Tiranë, TIRANE,Rr.LUNDER, Pasuria nr.583/57-N1, Zona Kadastrale 2529, përfaqësuar nga Administratori dhe ortakut i vetëm i shoqërisë zoti Roland Ziu, shtetas shqiptar, lindur më 26.10.1968, në Berat me adresë banimi në Tiranë, rruga Nikolla Tupe, nr.5 Tiranë, kati 10, identifikuar me letërnjoftim elektronik G81026092A.

ka vendosur të nënshkruajnë këtë Akt Themelimi për themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “East Hotel Tirana” shpk – në vijim referuar si “Shoqëria”.

Neni 1 – Forma e shoqërisë

- 1.1. Shoqëria themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.2. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.


Neni 2 – Emërtimi

2.1 Shoqëria ka emërtesën “East Hotel Tirana” shpk.

Neni 3 – Objekti i aktivitetit.

3.1 Shoqëria ka si objekt aktiviteti:

- a) administrimi i hoteleve, shtëpive të pushimit, kampeve, rezidencave, apo pasurive të tjera në pronësi, në përdorim ose me qira ose në formë tjetër administrim.
- b) tregtim të ushqimit dhe pijeve, bar, restorante, tratori, piceri, snack-bare, përfshirë shitjen e ushqimeve për “marrjen e ushqimit” dhe shpërndarjen në shtëpi dhe aktivitete ëmbëlsirash akullore dhe pasticeri;
- c) menaxhimin e ambienteve sportive dhe pishinave, marrjen ose dhënien me qira të pajisjeve dhe shërbimeve për sportin dhe kohën e lirë;
- ç) blerja, shitja dhe marrja dhe jepja me qira e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme dhe menaxhimi i shoqërive;
- d) aktivitet tregtar në fushën e pasurive të paluajtshme, qiradhënie, shitblerje, menaxhim qendrash tregtare dhe aktivitete të tjera,
- dh) aktivitet tregtar në eksport dhe import sipas lejeve/autorizimeve përkatëse,
- e) çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji për një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.



- 3.2 Shoqëria do të realizojë direkt ose indirekt, çdo aktivitet tregtar të lejuar nga ligji, që është i lidhur me objektin e saj të aktivitetit, apo për realizimin e qëllimeve.
- 3.3. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të hyjë në direkt ose indirekt në shoqëri të tjera, të cilat mund të kenë objekt tjetër aktiviteti, në përputhje me ligjin.

Neni 4 – Selia.

- 4.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Tiranë, Lundër, Pasuria me numër 583/57-N3, Zona Kadastrale 2529, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2 Asambleja e përgjithshme mund të ndryshojë selinë e shoqërisë, në një vend tjetër; të hapë filiale dhe degë; në Shqipëri ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5 – Kohëzgjatja.

- 5.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat deri në 31.12.2050.
- 5.2 Shoqëria mund të shpërndahej para kohe sipas parashikimeve ligjore dhe vendimarrjes së organeve të shoqërisë.

Neni 6 – Përgjegjësia.

- 6.1 Shoqëria nuk mban përgjegjësi për detyrime të marra përsipër nga ortakët në emrin e tyre personal jashtë shoqërisë.

KAPITULLI II KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 7 – Kapitali

- 7.1 Kapitali i shoqërisë është 100 000 (një qind mijë) lek.
- 7.2 Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë e nënshkruar që zotërohet nga Shoqëria “Praslin Investment” shpk.

Neni 8 – Shlyerja dhe zotërimi i kuotës.

- 8.1 Kapitali është si vijon:
1. Praslin Investment shpk, ka paguar vlerën 100 000 lek.
- 8.2 Kapitali zotërohet si vijon:
1. Praslin Investment shpk, i përket 1 kuotë e kapitalit që përbën 100 përqind.

Neni 9 – Zmadhimi i kapitalit

- 9.1. Asambleja e shoqërisë mund të zmadhojë kapitalin e shoqërisë.
- 9.2. Administratori i shoqërisë do të paraqesë në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit vendimin për zmadhimin e kapitalit dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm.
- 9.3. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv nga data e rregjistrimit dhe publikimit në QKR.

9.4. Zmadhimi i kapitalit me pasurinë e paluajtshme në pronësi të ortakut të shoqërisë realizohet me shpenzimet e ortakut themelues.

Neni 10 – Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë.

10.1 Pas miratimit të bilancit vjetor të mëparshëm, asambleja e përgjithshme mund të vendosë zmadhimin e kapitalit me fitimin që nuk është ndarë, dhe duke respektuar rezervat ligjore.

10.2 Rezervat që shkon mbi 1/10 e kapitalit të rregjistruar, dhe fitimet e pandara mund të transferohen për kapital themeltar.

10.3 Rezervat dhe fitimi i pandarë nuk mund të përdoren për zmadhim kapitali nëse bilanci i vitit parardhës nuk rezulton me humbje.

Neni 11 – Zvogëlimi i kapitalit

11.1 Asambleja e përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin, por jo nën minimumin e parashikuar nga ligji.

11.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga ortakët në përqindjen që ata kanë në shoqëri.

11.3 Vendimi i asamblesë së përgjithshme për zvogëlimin e kapitalit njoftohet në qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë.

Neni 12 – Transferimi i kuotës

12.1 Transferimi i kuotave tek persona të tretë jashtë shoqërisë bëhet vetëm me vendim paraprak të asamblesë së shoqërisë me vendim unanim.

12.2 Transferimi i kuotës për çdo arsye i nënshtrohet të drejtës së parablerjes nga ortakët e tjerë që e ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditëve që nga data që marrin njoftim me postë rekomande, letër e cila përmban edhe ofertën. Nëse ortakët nuk përgjigjen brenda afatit 30 ditor ata nënkuptohet se kanë hequr dorë nga e drejta e parablerjes.

12.3 Ortakët që e kanë shfrytëzuar të drejtën e parablerjes, kanë të drejtë që me të njëjtin procedurë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për ortakun që nuk e ka ushtruar këtë të drejtë.

12.4 Nëse e drejta e parablerjes ushtrohet nga më shumë se një ortak, atëherë pjesa e kuotës që kalohet në pronësi ndahet në përpjestim me përqindjen në kapital të secilit ortak që ushtron të drejtën e parablerjes.

12.5 Nëse e drejta e parablerjes ushtrohet nga një ortak ai blen kuotën ose një pjesë të saj.

12.6 Ortakët njoftojnë vendimin brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

12.7 Të gjitha njoftimet për procedurat e mësipërme, njoftohen nëpërmjet administratorit të shoqërisë.

12.8. E drejta e parablerjes nuk zbatohet nëse kuota i transferohet tërësisht ose pjesërisht tek bashkëshorti/bashkëshortja, ose tek të afërm në vijë të drejtë ose në rast trashëgimnie. Në këto raste transferimi nuk ka nevojë as për vendim asambleje.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSME, ADMINISTRIMI, KONTROLLI.

Neni 14 – Të drejta dhe detyrime:

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për të marrë këto vendime:

- 1) përcaktimi i politikave të shoqërisë;
- 2) ndryshimi i statutit;
- 3) emërimi dhe lirimi i administratorit/administratorëve ose shkarkimi i tij;
- 4) përcaktimi i kufizimeve të tërheqjes ose të transfertave bankare nga administratorit/administratorëve, për një pagesë ose për disa pagesa për periudhë të përcaktuar;
- 5) emërimi dhe revokimi i likuidatorëve dhe ekspertëve;
- 6) përfitimet ekonomike të administratorëve dhe likuidatorëve;
- 7) monitorimi i punës së administratorëve për realizimin e politikave ekonomike dhe hartimit të bilanceve të shoqërisë;
- 8) miratimi i bilancit të shoqërisë dhe ecuria e shoqërisë;
- 9) zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
- 10) ndarja dhe anulimi i kuotave;
- 11) përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë kundër administratorëve;
- 12) riorganizimi ose shpërndarja e shoqërisë;
- 13) miratimi i rregullave proceduriale të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme;
- 14) marrjen e vendimit për hyrje si ortak në shoqëri të tjera, investime në shoqëri të tjera, dhënie huaje, të japë garanci ose kolateral.
- 15) të marrë vendime për çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15 – Mbledhja e asamblesë së përgjithshme.

15.1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara nga ligji, nga akt i themelimit dhe statuti i shoqërisë dhe sa herë është e nevojshme nga interesat e shoqërisë.


15.2. Kur asambleja mbledhet pa respektuar afatin e parashikuar më sipër, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm me votë unanime dhe me pjesëmarrjen e gjithë ortakëve.

15.3. Asambleja thirret nga administratori në rastet e parashikuara nga statuti ose ligji si dhe me kërkesë të ortakëve të saj. Nëse janë dy administratorë mbledhja mund të thiorret dhe nga njëri prej tyre.

15.4. Një ortak që zotëron jo më pak se 20 përqind të kapitalit kërkon thirrjen e mbledhjes së asamblesë duke kërkuar dhe çështjet që do jenë objekt diskutimi në mbledhje. Mbledhja thirret brenda 30 ditëve nga kërkesa. Kërkesa e një ortaku për mbledhje nuk mund të refuzohet.

Neni 16 – Procedurat e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

16.1. Asambleja e shoqërisë mbledhet me njoftim me shkrim ose në formë elektronike. Njoftimi përmban ditën dhe orën, rendin e ditës dhe dokumentacionin përkatës, dhe i



njoftohet të gjithë ortakëve jo më pak se 7 ditë para datës së mbledhjes.
16.2. Kur asambleja mbledhet pa respektuar afatin e parashikuar më sipër, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm me votë unanime dhe me pjesëmarrjen e gjithë ortakëve.

Neni 17 – Kërkesat e ortakëve në minorancë.

17.1 Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të votave në asamblenë e përgjithshme, mund të kërkojnë nga administratorët me shkrim të mbledhin asamblenë e shoqërisë ose të fusin në rend dite të mbledhjeve çështje specifike.

17.2 Kërkesa duhet të ketë arsyetimin, dhe çështjet për të cilat asambleja duhet të marrë vendim. Nëse kërkesa refuzohet, ortakët kanë të drejtë të kërkojnë që asambleja të mbledhet me rend dite vetëm çështjet që ata kanë kërkuar.

Neni 18 – Përfaqësimi në asamble

18.1. Çdo ortak mund të përfaqësohet me akt nga një person tjetër.

18.2. Administratorët nuk mund të përfaqësojnë ortakët në mbledhje.

18.3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje, ose edhe për mbledhjet vijuese për çështjet e rendit të ditës që nuk janë shqyrtuar dhe marrë vendim.

Neni 19 – Kuorumi

19.1 Nëse shoqëria do të marrë vendime që kërkojnë një shumicë të thjeshtë, mbledhja konsiderohet e vlefshme nëse janë prezent ortakët që zotërojnë më shumë se 51 % e kapitalit të shoqërisë.


19.2. Nëse shoqëria nuk merr vendime sipas pikës më sipër, ajo mbledhet brenda 30 ditëve me të njëtin rend dite.

19.3 Shoqëria merr vendime që kërkojnë shumicë të cilësuar, nëse janë prezent ortakët që përfaqësojnë më shumë se 85 % e kapitalit të shoqërisë. Vendimet sipas nenit 20 në vijim merrem me shumicë të cilësuar.

Neni 20

20.1 Asambleja e përgjithshme merr vendim me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve prezent në mbledhje :

- për ndryshimin e statutit;
- miratimin e pasqyrave financiare dhe alokimin e fitimeve,
- shpenzimet mbi 1,000,000.00 lek, nëpërmjet transfertave ose tërheqjeve,
- shpërbërjen e shoqërisë, emërimi dhe shkarkimi i likuiduesit,
- blerja, shitja, marrja dhe jepja me qira e pasurisë së luajtshme të regjistruar për shuma që tejkalojnë 1.000.000,00 Lekë dhe të paluajtshme dhe të kompanive dhe pjesëve të tyre;
- ndryshimi në përdorimin e synuar të pronave të paluajtshme në pronësi ose pjesëve të tyre;
- miratimi i dispozitave në çështjet e përmendura në pikën d) të nenit 3 për shuma që tejkalojnë 1.000.000,00 Lekë;
- transferimi i zyrës së regjistruar jashtë kufijve të Bashkisë së Tiranës;
- përcaktimi i shpërblimit të Administratorëve dhe Likuiduesit për shuma që tejkalojnë 1,000,000.00 Lekë.



20.2 Asambleja e përgjithshme merr vendim me shumicë të thjeshtë për çështjet e tjera që pika më sipër ose ligji nuk kërkojnë një shumicë të cilësuar.

Neni 21 – E drejta e votës

21.1. Cdo kuotë ka të drejtën e një vote.

21.2. Ortakët, në përputhje me vullnetin tyre mund të marrin vendime unanime nëse kjo nuk ndalohet nga statuti ose nga ligji.

Neni 22 – Përfjashtimi nga e drejta e votës

22.1 një nga ortakët nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme vendos: a) të vlerësojë aktivitetin e tij; b) anulimin e cdo detyrimi të tij; c) procedurë denoncimi për të; ç) lejimi ose jo të shërbimeve të tjera.

22.2 Nëse ortaku që përfaqësohet me autorizim është në konflikt interesi, atëherë edhe përfaqësuesi është në të njëjtin konflikt interesi.

Neni 23 – Proces verbali i mbledhjes.

23.1 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme mbahen në proces verbal.

23.2 Proces verbali ka të dhëna si, vendi i mbajtjes së mbledhjes, data dhe ora, rendi i ditës, drejtuesi i mbledhjes, rezultatet e votimit, etj.

23.3 Proces verbali i bashkëlidhen lista e personave prezent në mbledhje, dhe njoftimi i mbledhjes.

23.4. Proces verbali firmoset nga drejtuesi dhe nga personi që mban proces verbalin.

Neni 24 – Hetimet e vecanta

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë të nisë një hetim të vecantë për parregullsi në veprimet e themelimit të shoqërisë ose në ushtrimin e aktivitetit tregtar në përputhje me nenin 91 të Ligjit nr. 9901, del 14/04/2008 me gjithë ndryshimet.

Neni 25 – Revokimi i vendimeve të parregullta dhe zhdëmtimi.


Asambleja e përgjithshme ka të drejtë të kërkojë para gjykatës kompetente anulimin e vendimeve të administratorëve kur ato janë marrë në shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit, në përputhje me nenin 92 të ligjit nr.9901/2008 me gjithë ndryshimet.

Neni 26 – Administrimi.

26.1. Shoqëria administrohet nga një ose dy administratorë. Asambleja e përgjithshme emëron administratorit/administratorëve për një periudhë kohe 5 vjecare me të drejtë riemërimi.

26.2. Administratori/administratorëve ka të drejta dhe detyrime:

- a) të kryejë administrimin e shoqërisë në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë;



c) të marrë masat e nevojshme për mbajtjen e saktë dhe në përputhje me ligjin të dokumentacionit financiar dhe dokumentave të tjerë të shoqërisë;

ç) të pregatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor dhe dhe raportet e aktivitetit së bashku me propozimin për ndarjen e fitimit, dhe të paraqesë në Asamblenë e Përgjithshme dokumentat për miratim;

d) të ndërtojë një sistem për lajmërimin në kohë për çështje dhe rrethana që rrezikojnë aktivitetin dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) ndjek dhe depoziton cdo vendim në QKR;

e) informon dhe raporton para Asamblesë së Përgjithshme mbi situatën e politikave tregtare dhe çështjeve specifike të rëndësisë së vecantë për aktivitetin e shoqërisë;

ë) ushtron të gjitha të drejtat e tjera që ja jep statuti dhe ligji.

26.3. Asambleja e Përgjithshme mund të lirojë nga detyra kurdoherë administratorin me shumicë të thjeshtë.

26.4. Administratori i parë emërohet zoti Roland Ziu, shtetas shqiptar, i datelindjes 26.10.1968, me adrese: rruga Nikolla Tupe, nr.5, kati 10 Tiranë, Shqipëri, identifikuar me letërnjoftim elektronik nr. G81026092A.

Neni 27 – Detyrimi për besmike dhe përgjegjësi

Administratori/ët është i detyruar që në ushtrimin e funksioneve parashikuara nga ligji dhe statuti të veprojnë me mirëbesim, në interesin më të mirë të shoqërisë në përgjithësi. Administratori/ët janë përgjegjës ndaj shoqërisë për cdo veprim që është kundër detyrave të tyre dhe kundër standarteve profesionale.

KAPITULLI IV NDARJA E FITIMIT

Neni 28 – Ndarja e fitimit

Ortakët ka të drejtë të ndajnë fitimin i rezultuar nga bilanci i shoqërisë. Fitimi ndahet sipas pjesëmarrjes në shoqëri.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA E SHOQËRISË


Neni 29 – rastet e shpërndarjes së shoqërisë.

Shoqëria shpërndahet:

1. Kur i mbaron afati i parashikuar;
2. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
3. Sipas procedurës të falimentit;
4. Sipas procedurës përkatëse nëse nuk ka aktivitet tregtar për dy vjet;
5. Me vendim gjykatë;

Neni 30 – Largimi i ortakut për motive të arsyeshme.

Një ortak mund të largohet ose përjashtohet nga shoqëria në kushtet dhe sipas procedurave të



parashikuara në Ligjin nr. 9901, del 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" me gjithë ndryshimet.

Neni 31 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

31.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në intepretim dhe zbatim të këtij akt themelimi (jo mosmarrëveshje jashtë shoqërisë që nuk kanë lidhje me shoqërinë), do të zgjidhen me mirëkuptim dhe do të diskutohen ndërmjet ortakëve që kanë mosmarrëveshje.

31.2. Në rast se nuk arrihet një marrëveshje për zgjidhje, atëherë kompetente për zgjidhejn e mosmarrëveshjes është Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 32 Shpenzimet e themelimit

32.1 Shpenzimet e themelimit përballohen nga themeluesi.

Ky akt themelimi hartohet dhe nënshkruhet në 4 kopje në gjuhën shqipe.

Ortaku

SHOQËRIA PRASLIN INVESTMENT SHPK

ROLAND ZIU

